

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Trump paralajmëron BE-në për tarifa të rënda pas afrimit me Kanadanë
ADRESA	https://albeu.com/lajme/bota/trump-para-lajmeron-be-ne-per-tarifa-te-renda-pas-afrimit-me-kanadane/1016313/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHÀ


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:08:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:07:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	15977a32a2f60d5e81fdc24911c93e48a3c53a7b943baa941cc0d68e1642dbf0
TEKSTI	ba44f691d6e6a062f40ecb2a75d2b1b5f0cdeaf6a6da465dc2d1b64880e2f8ff
PAMJA	546a7ffdba7a1557396dd8829e11c6f248858dd07326fe8cc95cf424b8f4b23a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a2503646f0021936995db536fe910d955cbc40046069e5f8da83ee70a8443910
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a2503646f0021936995db536fe910d955cbc40046069e5f8da83ee70a8443910>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Trump paralajmëron BE-në për tarifa të rënda pas afrimit me Kanadanë



Afrimi mes Bashkimit Evropian dhe Kanadasë ka nxitur një reagim të fortë nga presidenti i SHBA-së, Donald Trump, i cili paralajmëroi vendosjen e tarifave të larta doganore, madje edhe ndërprerjen e marrëdhënieve tregtare me BE-në.

Në një tubim të zhvilluar në SHBA, Trump e quajti "qesharake" mundësinë e krijimit të një partneriteti më të ngushtë ndërmjet Kanadasë dhe Bashkimit Evropian. Ai tha se do të ndërmerre masa ekonomike nëse një marrëveshje e tillë do të shihej si veprim armiqësor ndaj SHBA-së.

"Do të vendosja tarifa shumë të rënda ndaj produkteve që vijnë nga Evropa. Nëse do ta bënin këtë, nuk do të bënin gjë tjetër veçse do ta përkeqësonin situatën", deklaroi Trump.

Këto komente të presidentit amerikan erdhën pasi Kanadaja dhe BE-ja çuan përpara bisedimet për thellimin e një partneriteti që synon zgjerimin e bashkëpunimit ekonomik dhe strategjik.

Në kundërshtim me qëndrimin e Trump, kryeministri kanadez Mark Carney e vlerësoi pozitivisht forcimin e raporteve të Kanadasë me BE-në. Sipas tij, një Kanada më e fuqishme do të ishte një partnere më e mirë edhe për Shtetet e Bashkuara.

"Një aleancë është një proces pozitiv. Një Kanada më e fortë dhe më rezistente është një partnere më efektive edhe për SHBA-në, dhe e njëjta gjë vlen për BE-në", u shpreh Carney në një konferencë për shtyp së bashku me presidenten e Parlamentit Evropian, Roberta Metsola.

Kryeministri kanadez theksoi se bashkëpunimi me Evropën do të kontribuonte në forcimin e sovranitetit të Kanadasë dhe do ta bënte vendin më të qëndrueshëm përballë krizave dhe goditjeve nga jashtë.

Carney sqaroi njëkohësisht se përdorimi i termit "anëtar i asociuar" nuk do të thotë se Kanadaja kërkon

të fundit /



Albin Kurti zhvilloi takim me kreun e PDK-së, Bedri Hamza



Jovota: Bullgaria i ka përmbyshur të gjitha kërkesat...



Protesta para Kuvendit shoqërohet me tensione, policia...



Tromp: Serbia do ta shfrytëzojë aktgjykimin si armë juridike kund...



Vendimi i Hagës dhe ndikimi i tij në historinë e luftës së Kosovës



Debat i pagat e gjyqësorit, EAJ kundërshton...



Bosch sugjeron se presidenti i ardhshëm i Kosovës mund t'i falë...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

anëtarësim me të drejta të plota në Bashkimin Evropian.

"Kanadaja nuk është në pozicion dhe nuk ka synim të bëhet anëtare me të drejta të plota e Bashkimit Evropian. Ajo që ka rëndësi është përmbajtja", deklaroi ai.

Si Carney, ashtu edhe Metsola, kanë mbrojtur idenë se lidhjet më të afërta mes Evropës dhe Kanadasë mund t'u shërbejnë të dyja palëve për të fuqizuar sigurinë, prosperitetin dhe autonominë strategjike.

"E ardhmja është e jona", tha Carney, duke përfurcuar qëndrimin e Metsolës se Evropa dhe partnerët e saj duhet të marrin më shumë përgjegjësi për të ardhmen e tyre.

Përpara se një aleancë e tillë të finalizohet, marrëveshja duhet të miratohet ende nga institucionet përkatëse në Kanada. Ndërkaq, paralajmërimet e Trump sinjalizojnë se afrimi mes BE-së dhe Kanadasë mund të krijojë një front të ri në raportet tregtare ndërmjet Uashingtonit dhe Brukselit.

Shtuar më 17.09.2026 18:07



Gjendet në pellg trupi i 3-vjeçarit, babai: Noah ishte i ëmbël, i pafajshëm dhe p...



Erdogan: Anëtarësimi në BE nuk është më përparësi për Turqinë, humbjen do ...



Indonezi, çifti merr nga 100 goditje me kamxhik për tradhti bashkëshortore;...



Carney përshëndet synimin e BE-së për forcimin e aleancës strategjike me...



Kremlini paralajmëron: Sanksionet e reja amerikane pengojnë...



Rezerva Federale rrit interesat në SHBA pavarësisht presionit të...



Gjermania në alarm nga "malaria e aeroportit", 8 raste dhe dy viktima në...



Itali, ministrit të Arsimit i dërgohet zarf me plumb dhe kërcënime, Meloni:...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.